

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Korrik 2026

BULETINI

m u j o r



www.mod.gov.al





SHËRBIMI I NDËRLIDHJES KREMTON 95-VJETORIN, MINISTRI NUFİ: “KOMPOONENT STRATEGJIK I SIGURISË KOMBËTARE”

Komanda Kibernetike e Ndërlidhjes, pjesë e Forcave të Armatosura (FA), kremtoi 95-vjetorin e krijimit të Shërbimit të Ndërlidhjes. Në fjalën e tij, Ministri Nufi theksoi se, Shërbimi i Ndërlidhjes është një komponent shumë i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm i FA, pa të cilin asnjë operacion nuk mund të realizohet, pasi siguron komunikimin. “Mirënjohje për të gjithë burrat dhe gratë që ndër breza kanë shërbyer, si dhe për ata që shërbejnë sot me profesionalizëm dhe përkushtim në Shërbimin e Ndërlidhjes” - u shpreh ai.






HAPET SHKOLLA KOMBËTARE E FLUTURIMIT, MINISTRI NUFI: “PËRGATISIM PILOTËT SIPAS STANDARDEVE TË NATO-S”

Shkolla Kombëtare e Fluturimit është një investim strategjik që shënon një etapë të re në modernizimin e Forcës Ajrore dhe fuqizimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit. Në ceremoninë e hapjes së shkollës, Ministri Nufi tha se ajo do të shërbejë si qendër moderne trajnimi për pilotët dhe kontrollorët e fluturimit, duke u bazuar në standardet më të avancuara të NATO-s dhe në metodologji bashkëkohore të trajnimit ajror. Forca jonë Ajrore do të përfitojë 5 pilotë të trajnuar në vit për secilin nga 5 vitet e ardhshme.





ANKARA, NUFI ME MINISTRAT E MBROJTJES TË VENDEVE TË ALEANCËS: “MOMENT I MIRË PËR FORCIMIN E MARRËDHËNIEVE”

Në kuadër të Samitit të NATO-s të zhvilluar në Ankara, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi mori pjesë në pritjen joformale të organizuar nga Ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Yaşar Güler, për ministrat e mbrojtjes të vendeve aleate të NATO-s. “Samiti në Ankara ishte një moment i mirë për të forcuar më tej marrëdhëniet mes aleatëve, për të shkëmbyer mendime mbi çështjet e sigurisë dhe për të riafirmuar rëndësinë e bashkëpunimit, solidaritetit dhe unitetit brenda NATO-s.” - u shpreh Ministri Nufi.



PËRFUNDON VITI AKADEMIK NË KOLEGJIN E MBROJTJES DHE SIGURISË, DIPLOMOHEN 83 OFICERË NGA SHQIPËRIA DHE KOSOVA

83 kursantë nga Shqipëria, mes të cilëve edhe 7 nga Forca e Sigurisë së Kosovës përfunduan me sukses vitin akademik 2025–2026 në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, duke u diplomuar në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) dhe Kursin e Lartë të Oficerit (KLO). I pranishëm në këtë ceremoni, Ministri i Mbrojtjes Nufi nënvizoi se diplomimi është nisje e një investimi strategjik për leadershipin e ardhshëm të Forcave të Armatosura



SHEFI I GRUPIT USHTARAK AMERIKAN NË SHQIPËRI JOSHUA MAGNUSSON MBYLL MANDATIN, MINISTRI NUFI I JEP "MEDALJEN E ARTË TË SHËRBIMIT USHTARAK"

Kontributi i shefit të Grupit Ushtarak Amerikan në Shqipëri nënkolonel Joshua A. Magnusson, “në forcimin e partneritetit ndërmjet SHBA dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, dhe për merita të veçanta në realizimin dhe qëndrueshmërinë e programeve të bashkëpunimit ushtarak”, bëri që Ministri i Mbrojtjes Nufi t'i akordonte "Medaljen e Artë të Shërbimit Ushtarak". Akordimi i medaljes përkon edhe me përfundimin e mandatit të nënkolonelit amerikan në krye të këtij misioni. “Nderim dhe respekt për këdo që ka kontribuar dhe kontribuon në forcimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe SHBA-së,” - tha Ministri Nufi gjatë aktivitetit.



MINISTRI NUFI PRET SHEFIN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË GJERMANISË, GJENERAL CARSTEN BREUER

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi mikpriti në një takim kortezie shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, gjeneral Carsten Breuer, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë. Gjatë takimit u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira mes Shqipërisë dhe Gjermanisë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe roli i Gjermanisë si një nga aleatët më të rëndësishëm të NATO-s dhe një kontribuues kyç për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë. Gjeneral Carsten Breuer u prit në takim edhe nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjenerallejtënant Arben Kingji.



MINISTRI NUFI INSPEKTON INVESTIMIN E KOMPANISË GUNA TACTICAL: “INDUSTRIA E MBROJTJES, NJË SHTYLLË E RE E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE SIGURISË KOMBËTARE

Ministri i Mbrojtjes z. Ermal Nufi, së bashku me zëvendëskryeministren e Republikës së Shqipërisë, znj. Albana Koçiu, zhvilluan një vizitë inspektuese në kantierin e kompanisë “Guna Tactical”, ku po ndërtohet një nga investimet më të rëndësishme në industrinë shqiptare të mbrojtjes. Gjatë vizitës u vlerësua ecuria e punimeve dhe rëndësia strategjike e këtij investimi, i cili përfaqëson një hap konkret në drejtim të zhvillimit të një industrie moderne të mbrojtjes, me potencial të lartë për të kontribuar në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe forcimin e kapaciteteve kombëtare të sigurisë.



MINISTRI NUFI VLERËSON ME CERTIFIKATË MIRËNJOHJEJE ATASHEUN USHTARAK TË BULLGARISË

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi i dorëzoi Certifikatën e Mirënjohjes kolonel Miroslav Sandrev, atashut ushtarak të Republikës së Bullgarisë në Shqipëri, me rastin e përfundimit të misionit të tij diplomatik në vendin tonë. Ministri Nufi vlerësoi kontributin e kolonel Sandrev në forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes, duke theksuar rolin e tij në zhvillimin e marrëdhënieve mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Bullgarisë. Ai nënvizoi se angazhimi i kolonel Sandrev ka shërbyer në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve aleate në NATO, duke kontribuar në avancimin e partneritetit dhe koordinimit në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.



ATASHEU USHTARAK I TURQISË NË SHQIPËRI VLERËSOHET ME CERTIFIKATË MIRËNJOHJEJE NGA MINISTRI NUFI

Në mbyllje të mandatit të tij në vendin tonë, atasheu ushtarak i Turqisë në Shqipëri, kolonel Tolga Kip është vlerësuar me Certifikatë Mirënjohjeje nga Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi. Ministri Nufi i ka akorduar Certifikatën e Mirënjohjes për kontributin e veçantë të kolonel Kip në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Turqisë, si dhe në thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. “Shqipëria dhe Turqia, aleate në NATO dhe partnere strategjike, vijojnë të ndërtojnë një bashkëpunim të ngushtë, të bazuar në besim të ndërsjellë dhe mbështetje konkrete për modernizimin e Forcave të Armatosura, zhvillimin e kapaciteteve ushtarake, trajnimin e personelit dhe koordinimin në kuadër të misionëve ndërkombëtare”, - u shpreh Ministri Nufi.



MINISTRI NUFI: “SHQIPËRIA PO PËRGATITET PËR FAZËN E RE TË NATO-S, ME MË SHUMË INVESTIME NË MBROJTJE DHE MODERNIZIM TË FORCAVE TË ARMATOSURA”

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi zhvilloi një konferencë për media, ku prezantoi prioritetet strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes, zhvillimet në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut, investimet në mbrojtje dhe masat në përballimin e situatës së zjarreve në vend. Gjatë konferencës, ai e cilësoi vendimin për organizimin e Samitit të ardhshëm të NATO-s në Tiranë si një vlerësim të rëndësisë strategjike të Shqipërisë dhe rolit të saj gjithnjë e më të madh në Aleancë. Ministri Nufi theksoi ndër të tjera se NATO po hyn në një fazë të re zhvillimi, të njohur si NATO 3.0, dhe se Shqipëria po përgatitet për t'iu përgjigjur këtij realiteti të ri përmes rritjes së kapaciteteve mbrojtëse dhe investimeve strategjike.



SHQIPËRIA DËRGON NJË TOGË KËMBËSORIE NË RUMANI NË KUADËR TË STRUKTURAVE TË NATO-S PËR FORCIMIN E SIGURISË KOLEKTIVE

Shqipëria vijon të japë kontribut aktiv në përmbushjen e angazhimeve të saj si vend anëtar dhe i besueshëm i NATO-s. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave u miratua vendimi për angazhimin në Rumani të një toge këmbësorie prej 30 ushtarakësh të Forcave të Armatosura, në kuadër të strukturave të NATO-s për mbrojtjen e krahut jug-lindor të Aleancës. “Ky angazhim është pasqyrim i drejtpërdrejtë i përkushtimit të Shqipërisë në forcimin e sigurisë kolektive, mbështetjen e strukturave shumëkombëshe të NATO-s, si dhe kontributit të saj në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar”, - tha Ministri Nufi gjatë konferencës.



DIPLOMOHEN 67 OFICERË TË RINJ NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA, MINISTRI NUFI: “INVESTIMI NË ARSIMIN USHTARAK, INVESTIM NË TË ARDHMEN EUROATLANTIKE”

67 oficerë të rinj, mes tyre 10 nga Republika e Kosovës përfunduan me sukses programin një-vjeçar të Kursit të Përgatitjes së Oficerëve në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA). Në fjalën e tij, Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi u shpreh se “Shqipëria fitoi një brez të ri udhëheqësish të përgatitur mirë për t’i shërbyer Atdheut, qytetarëve dhe për të përfaqësuar me dinjitet flamurin shqiptar. Investimi në dije është i vetmi investim në sigurinë tonë të përbashkët në të ardhmen tonë euroatlantike”.





RATIFIKIMI I MARRËVESHJES SË HUASË MES SHQIPËRISË DHE SHBA-SË, MINISTRI NUFI: "NGJARJE HISTORIKE DHE INVESTIM STRATEGJIK PËR SIGURINË E VENDIT"

Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi e ka cilësuar ratifikimin nga Kuvendi të Marrëveshjes së Huasë direkte mes Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës si një ngjarje historike dhe një dëshmi konkrete e mbështetjes strategjike amerikane për vendin tonë. Sipas Ministrit Nufi, që nga rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-në në vitin 1990 dhe pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ky është akti më domethënës i mbështetjes ndaj Shqipërisë në terma konkretë dhe financiarë. Nufi thekson se marrëveshja nuk është thjesht një instrument financiar, por një investim strategjik që do të shërbejë për sigurinë kombëtare në kuadër të NATO 3.0 dhe angazhimit të Shqipërisë në Aleancë, forcimin e kapaciteteve dhe modernizimin e Forcave të Armatosura, si edhe thellimin e partneritetit strategjik mes dy vendeve.



PËRGATITJET PËR SEZONIN E ZJARREVE, MINISTRI NUFI: “SHQIPËRIA MË E PËRGATITUR DHE MË E KOORDINUAR SE KURRË NË PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE”

Në Bazën Ajrore të Farkës u zhvillua aktiviteti për prezantimin e kapaciteteve dhe gatishmërisë së strukturave të mbrojtjes civile për sezonin e zjarreve. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi theksoi se: “Shqipëria është sot më e përgatitur dhe më e koordinuar se kurrë për t’u përballur me emergjencat civile, duke nënvizuar se ky është viti më i mirë sa i përket menaxhimit të zjarreve”.

"Sot, me krenari them se ky mund të jetë ndër vitet më të mira për sa i përket situatës së menaxhimit të zjarreve. Kjo nuk është për shkak të fatit apo rastësisë, por falë koordinimit dhe angazhimit të jashtëzakonshëm të të gjitha strukturave që menaxhojnë situatat emergjente.", u shpreh Ministri Nufi.



PËRFUNDOJNË ME SUKSES KURSET ELITARE "KOMANDO" DHE "OPERATOR I ZBULIMIT", MINISTRI NUFI: "FORCAT SPECIALE, NË VIJËN E TRANSFORMIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA"

Në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS), në Zall Herr u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit "Komando" dhe kursit të "Operatorit të Zbulimit". Në fjalën e tij, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi përgëzoi kursantët për përfundimin me sukses të dy prej kurseve më kërkuese të Forcave të Armatosura, duke e cilësuar këtë moment si kurorëzim të një prove karakteri, profesionalizmi dhe përkushtimi. Të pranishmit ndoqën skenarë të mbijetesës, ndërtimit të pikës së vrojtimit, operacioneve të zbulimit dhe mbikëqyrjes së objektivave me vlerë të lartë, ndërhyrjes në godinë, përdorimit të sistemeve pa pilot, tërheqjes në fushën e luftimit, njohurive të armatimit dhe luftimit trup më trup.



MIRATOHET SHPËRBLIMI PËR FORCAT E ARMATOSURA DHE STRUKTURAT E ANGAZHUARA NË SHUARJEN E ZJARREVE

Ministri i Mbrojtjes, Nufi, njoftoi se Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për shpërblimin e Forcave të Armatosura dhe të gjitha strukturave të angazhuara në menaxhimin e situatës së zjarreve, duke mbajtur kështu premtimin e bërë publikisht nga Kryeministri.

“Një shpërblim i merituar për njerëzit e punës e sakrificës që janë në vijë të parë të frontit për të siguruar jetën e qytetarëve, banesave e më gjerë.” – është shprehur ai.



MINISTRI NUFI: “QEVERIA MIRATON PROJEKTAKTIN PËR NISJEN E MISIONIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË GAZA”

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, njoftoi se Këshilli i Ministrave ka miratuar projekt-aktin ligjor që do t'i dërgohet Kuvendit për miratimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në misionin ndërkombëtar në Gaza.

Sipas tij, “Shqipëria do të ketë fillimisht një përfaqësi me 4 oficerë shtabi në përputhje me mandatin e Këshillit të Sigurimit dhe Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese. Me vajtjen e këtyre trupave, do të vlerësohet më pas edhe niveli konkret i angazhimit”, - ka nënvizuar Nufi para gazetarëve pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave.



40 MJETE TAKTIKE TË PRODHUARA NGA INDUSTRIA SHQIPTARE I SHTOHEN FA, MINISTRI NUFI: “OBJEKTIV, TË NDËRTOJMË NJË INDUSTRI MODERNE TË MBROJTJES”

40 mjete taktike të prodhuara "Timak Defence" - partneritet mes kompanisë shtetërore "KAYO" dhe kompanisë "TIMAK" - iu dorëzuan Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të procesit të modernizimit të kapaciteteve operacionale dhe zhvillimit të industrisë vendase të mbrojtjes. Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi e cilësoi këtë moment si një ditë krenarie për industrinë shqiptare të mbrojtjes. Ai nënvizoi se zhvillimi i industrisë vendase të mbrojtjes është tashmë një objektiv strategjik, i lidhur me nevojat kombëtare të sigurisë dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

www.mod.gov.al

